

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konflikti për pronën në Vlorë mes 2 biznesmenëve, reagon Kadastra: I kemi kërkuar SPAK të verifikojë ti tujt e pronësisë
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/konflikti-per-pronen-ne-vlore-mes-2-biznesmeneve-reagon-kad-astro-i-ke-i46185
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:48:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 19:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d15772f7dd1a1dfbe56ab041deb2eac6f2dda33b6e53837b2b8b45482eab5aee
TEKSTI	f10f3961ae20309ce079a9a58740f76743b3d268e5a9c854bc55257b91d71178
PAMJA	c6325e8ae0e9bd39978008e39d3dfa0b7897e461ab57f23db2dd1fcd53b2f290

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c01863b2a02e1cb521c2128cc037ebc0d5c28fbf225e2365141b6b73bc8d28bf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c01863b2a02e1cb521c2128cc037ebc0d5c28fbf225e2365141b6b73bc8d28bf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

Reforma Territoriale, përplasje mes Ramës dhe aktore Egl Ceno, banorët e Poliçanit bojkotojnë takimin

13 Shtator 2026, 18:17

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 7 Shtator 2026, 21:21

Konflikti për pronën në Vlorë mes 2 biznesmenëve, reagon Kadastra: I kemi kërkuar SPAK të verifikojë titujt e pronësisë

ASHK konfirmon gjithashtu se më 24 korrik 2024 është regjistruar në regjistrin e veçantë të lejeve të ndërtimit leja për resortin “Delta Falaise Resort & Village, Zona 1”.



Shënim: Aktualiteti



Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka reaguar lidhur me konfliktin e pretendimeve për pronësinë e një sipërfaqeje toke në zonën mes Drimadhës dhe Palasës, ku është parashikuar ndërtimi i resortit “Delta Falaïse Resort & Village”.

Në një përgjigje për “Top Story”, ASHK sqaron se zona në fjalë i përket Zonës Kadastrale nr. 1739. Procesi i regjistrimit fillestar të pronave në këtë zonë, në bazë të një marrëveshjeje mes ASHK-së dhe Bashkisë Himarë, pritet të përfundojë brenda vitit 2027.

Sipas Kadastrës, shoqëria “Delta” sh.a. ka depozituar gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 dokumentacion ligjor për disa tituj pronësie, të fituar përmes kontratave të shitblerjes. Origjina e këtyre titujve lidhet me vendime të ish-komisioneve të kthimit të pronave, vendime gjykatash dhe AMTP.

ASHK konfirmon gjithashtu se më 24 korrik 2024 është regjistruar në regjistrin e veçantë të lejeve të ndërtimit leja për resortin “Delta Falaïse Resort & Village, Zona 1”. Sipas institucionit, kjo është e vetmja leje ndërtimi e regjistruar deri më tani në lidhje me këtë çështje.

Sa i përket subjektit tjetër të përfshirë në konfliktin e pretendimeve pronësore me “Delta” sh.a., Kadastra thotë se nuk rezultojnë të ketë paraqitur kërkesë apo të jetë pajisur me vërtetim pronësie për zonën në fjalë.

Por, sipas ASHK-së, në të njëjtën zonë është paraqitur një kërkesë dhe në korrik 2024 është lëshuar vërtetim pronësie në emër të një individi tjetër. Titulli i pronësisë së këtij individi, sipas Kadastrës, e ka origjinën nga një vendim i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Pikërisht ky titull pronësie ka ngritur dyshime për një falsifikim të mundshëm. ASHK bën me dije se, pas verifikimeve administrative, në vitin 2025 ia ka përcjellë dokumentacionin përkatës Strukturës së Posaçme Antikorrupsion për vlerësim të mëtejshëm.

“Për këtë titull pronësie, në kuadër të verifikimeve administrative të kryera dhe për çështje që kërkojnë vlerësim nga organet kompetente, ASHK ka përcjellë në vitin 2025 pranë Strukturës së Posaçme Antikorrupsion, dokumentacionin përkatës duke qenë se ka pasur dyshime të arsyeshme për një falsifikim të mundshëm”, thuhet në përgjigjen e ASHK-së.

Kadastra sqaron gjithashtu se, në zonat ku regjistrimi fillestar nuk ka përfunduar, vërtetimi i pronësisë ose vërtetimi hipotekor shërben si provë se subjekti ka depozituar pranë ASHK-së dokumentet ligjore që disponon për titullin e pronësisë.

Sipas institucionit, këto vërtetime janë të vlefshme për përdorim nga pronari dhe autoritetet publike deri në përfundimin e procesit të regjistrimit fillestar.

Ndërkohë, për kërkesat për kopje të dokumenteve origjinale të pronësisë apo dokumentacionit arkivor të subjekteve private, ASHK thotë se duhet të respektojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe atë për kadastrën. Dokumentacioni individual mbi një pasuri mund t’u vihet në dispozicion pronarëve, titullarëve të të drejtave pronësore ose personave që provojnë një interes të ligjshëm mbi pasurinë.

Poll



AKTUALITET

[Dita 106 e revoltës ndaj qeverisë, nga nesër ndryshon orari i protestës](#)

13 Shtator 2026, 20:06

^ekstrakti^



AKTUALITET

["Nuk e di se kush janë hasmit e babait tim", djali i Franc Konomit që u v*a në 2010-ën: Dua të kem mbiemrin e tij](#)

13 Shtator 2026, 18:53

^ekstrakti^



AKTUALITET

[U siguroi shqiptarëve 20 apartamente për t'i kthyer në 'shtëpi bari', dënohet drejtori i agjencisë imobilare](#)

13 Shtator 2026, 16:32

^ekstrakti^



AKTUALITET

["300 mijë € futi tek depozita e gazit", i shkroi letër anonime kushërirrit, autori u zbulua nga gabimet gramatikore](#)

13 Shtator 2026, 15:17

^ekstrakti^



AKTUALITET

Tritoli në Shkodër, autori u maskua si picajol! Dyshohet mesazh kërcënues për vëllain e mësuesit

13 Shtator 2026, 15:04

^ekstrakti^



AKTUALITET

“Larje hesapesh” nga Italia?/ 35 plumba drejt banesës në Mat, Akil Lleshi dyshohet se ishte objektivi i atentatit

13 Shtator 2026, 12:53

^ekstrakti^



AKTUALITET

EMRI/ Operacioni ‘Mesazhi’ në Vorë, kërcënoi kushëririn për t’i marrë 300 mijë €, në pranga 56 vjeçari

13 Shtator 2026, 12:31

^ekstrakti^



AKTUALITET

VIDEO/ Makinat luksoze në “lupën” e Policisë së Vlorës: Sekuestrohen 3 mjete, nis hetimi ndaj pronarëve

13 Shtator 2026, 12:09

^ekstrakti^

Të fundit





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.